

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Anita Krasniqi Prenaj, me sekretaren juridike Fexhrie Tashevci, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.S.i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore nga Prishtina, PP.II.nr.3151/14, të dt.27.03.2015 për shkak të veprës penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën Prokurorisë Themelore në Prishtinë për dhënien e urdhrit ndëshkimor: dënim me gjobë, me datë 14.03.2018, mori:

A K T G J Y K I M

Pranohet Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.3151/14, të dt.27.03.2015 gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari:

H.S. nga i ati H. dhe e ëma K., i lindur më dt. ..., me nr. personal ..., në B., me vendbanim rr. " L.D. ", pa numër, në P., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më datë 25.03.2014, pas inspektimit që është bërë në shtëpin e të pandehurit H.S. në rr. " L.D. " p.n., në P., është konstatuar se i njëjti pa leje apo autorizim nga ana e personave të autorizuar të K. nga njehsori elektrik nr. 35016970, ka hequr dhe dëmtuar pllombën e distributive nr.D-1072879, të vendosur nga personat kompetent të K. Distribucioni në P..

Me këtë ka kryer veprën penale- Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KPRK-së -

Andaj gjykata konform neneve 3, 7, 17, 21, 41, 43, 46 të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 495 të KPPK-së, ju shqipton këtë:

DËNIM ME GJOBË

I akuzuari **H.S.** dënohet me gjobë në shumë prej **200€ (dyqind euro)**, të cilën obligohet të e paguaj me 2 (dy) këste në afatin ligjore prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20€, të gjobës.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25€, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën PP.II.nr.3151/14, të dt.27.03.2015 ka akuzuar, H.S.se ka kryer veprën penale – Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KPRK-së dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjyqtari i çështjes me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: Procesverbali për gjendjen e njëisorit elektrik të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, duke i marr për bazë të gjitha faktet dhe provat, u vërtetuar se ndaj të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën akuzohet.

Vendimi për kompensimin e paushallit gjyqësor u mor konform nenit 450 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463 par 1 dhe 2 të KPPK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Nga sa u tha më lartë në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË P.nr.1007/15 dt.14.03.2018

*Procesmbajtësja,
Fexhrie Tashevc*

*Gjyqtarja
Anita Krasniqi Prenaj*

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi – urdhëri ndëshkimor, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimin të tij, në këtë gjykatë.